



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:230769

Datë: 17.09.2024

Numri i dokumentit: 06171771

C.nr.143/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Banka Ekonomike Sh.A, Rr.”Qamil Hoxha”, nr.51, në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Kompania e Avokatëve ”Arbëresh”, kundër të paditurit Shemsi Krasniqi, ish- nga Rr.”Dardania”, Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti kthim i borxhit, jashtë seancës, më datë 17.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. NDËRPRITET procedura në këtë çështje juridike kontestimore sipas padisë C.nr.143/2019, të datës 05.04.2019, të paditëses Banka Ekonomike Sh.A, për shkak të vdekjes së të paditurit Shemsi Krasniqi.
- II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të paditurit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës paditëse.

A r s y e t i m

Paditësja ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datën 05.04.2019, kundër të paditurit Shemsi Krasniqi, lidhur me çështjen me objekt kontesti kthim i borxhit.

Gjykata me datë 08.07.2024, ka marrë aktvendim me të cilin e ka detyruar të paditurin të përgjigjet në padi si dhe e ka ftuar për seancën përgatitore të caktuar me datë 06.08.2024, mirëpo nga fletkthesa e postës është konstatuar se *“pala ka ndërruar jetë në vitin 2016 sipas djalit së të ndjerit (Artan Krasniqi)”*.

Gjykata më datë 12.08.2024, më qëllim të vërtetimit të faktit të vdekjes së të paditurit Shemsi Krasniqi, ka kërkuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Komunës së Vushtrrisë, certifikatën e vdekjes së të njëjtit.

Zyra e Gjendjes Civile Komuna e Vushtrrisë, pas pranimit të kësaj kërkesë, në mënyrë elektronike i'a ka dorëzuar gjykatës certifikatën e vdekjes për të paditurin Shemsi Krasniqi, me nr. serik V10703002, përmes së cilës vërtetohet se i padituri Shemsi Krasniqi, ka vdekur me datë 11.12.2016, në Prishtinë.

Prandaj gjykata konform nenit 277 pika (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), sipas të cilës thuhet: *“Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale”*, vendosi si në dispozitivin I të këtij aktvendimi sepse është vërtetuar se i padituri ka vdekur në vitin 2016, kurse për vendimin si në dispozitivin II, të tij vendosi duke u bazuar në nenin 280 par 1, të LPK-së.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:230769, C.nr.143/2019, me datë 17.09.2024**

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas pranimit të së njëjtit, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.